



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:255287
Datë: 18.11.2024
Numri i dokumentit: 06465185

Pml.nr.665/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit Gj. M., për shkak të veprave penale: dhënia e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK0, ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së dhe mashtrimi me subvencione në vazhdim nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KPRK-së dhe kundër të dënuarit H. B., për shkak të veprave penale: dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së dhe mashtrimi me subvencione nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.20/2024 të datës 13.03.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.23/2024 të datës 10.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31 tetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve Gj. M. dhe H. B. të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -

Departamenti Special PS.nr.20/2024 të datës 13.03.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.23/2024 të datës 10.07.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.20/2024 e datës 13.03.2024, të dënuarin Gj. M. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, për veprën penale me ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) € dhe për veprën penale mashtrimi me subvencione në vazhdim nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 03.12.2021 deri me datë 03.05.2024, kurse të dënuarin H. B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) € dhe për veprën penale mashtrimi me subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 03.12.2021 deri me datë 03.05.2024. Të dënuarit janë obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej nga 100 €, si dhe nga 50 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.23/2024 e datës 10.07.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit Gj. M., avokati Kujtim Kërveshi nga P., për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të e aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësi i të dënuarit H. B., avokati Admir Salihu nga F., për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo gjykatën e shkallës së dytë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.385/2024 e datës 28.10.2024, ka propozuar që kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve të refuzohet si të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesa

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit Gj. M. thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë me rastin e veçimit të procedurës penale është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, konkretisht në vendimin për sanksionin penal. Duke cituar dispozitën e nenit 242 par.6 të KPP-së, pretendohet se veçimi i procedurës penale kundër të dënuarit Gj. M. është në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar, meqë shqiptimi i dënimit do të duhej të pezullohej deri në përfundimin e bashkëpunimit nga ana e të dënuarit me prokurorinë e shtetit. Pretendohet se pezullimi i shqiptimit të dënimit deri në përfundim të bashkëpunimit nga ana e të dënuarit me prokurorin e shtetit për faktin se varësisht prej deklarimeve dhe kontributit të tij rreth zbardhjes së çështjes do të duhej të llogaritej me rastin e matjes së dënimit. Kurse mënyra e veprimit të kryetarit të trupit gjykues, përkatësisht veçimi i procedurës penale dhe shqiptimi i dënimit lë të hapur mundësinë

që dëshmitari bashkëpunues fare të mos bashkëpunoj në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor ndaj të akuzuarve të tjerë e që kjo bie në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësit që ka paraparë mundësinë e pezullimit të dënimit deri në përfundimin e bashkëpunimit mes të pandehurit dhe dhe prokurorit të shtetit.

Në vijim të kërkesës janë paraqitur pretendime lidhur me faktin se tani i dënuari njëkohësisht ka cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe duke e marrë parasysh këtë fakt gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënim të rëndë, përkatësisht dënim më të rëndë se sa i ishte premtuar se do të i shqiptohet dënim me kusht. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese ka marrë parasysh bashkëpunimin dhe sjelljen e të dënuarit, meqë i njëjti është shpallur dëshmitar bashkëpunues nga ana e PSRK-së, mirëpo vlerësimi i bashkëpunimit si rrethanë lehtësuese nuk është i mjeftueshëm dhe në harmoni me dispozitën e nenit 230 par.6 të KPP-së, meqë shqiptimi i dënimit do të duhej të pezullohej deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe pas deklarimit të tij dënimi të shqiptohet sipas kontributit të tij.

Mbrojtësi i të dënuarit H. B., thekson se kundër të dënuarit janë duke u zhvilluar dy procedura penale sipas rastit i njohur si “Subvencionet”, për shkakun se kjo çështje është ndarë në disa pjesë, kurse kundër të dënuarit përveç çështjes për të cilën i njëjti është shpallur fajtor dhe është gjykuar sipas këtij aktgjykimi i cili është objekt i kësaj kërkesë e cila evidentohet nga ana e PSRK-së me numër të aktakuzës PPS.nr.89/2023 e datës 22.11.2023, gjithashtu është duke u zhvilluar edhe procedura penale e evidentuar sipas aktakuzës PPS.nr.88/2021 e datës 04.12.2021 e për të cilën çështje i pandehuri H. B. ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe e cila marrëveshje është nënshkruar nga ana e palëve në procedurë penale.

Mbi këtë bazë dhe duke marrë parasysh faktin se në të dy rastet i pandehuri akuzohet për dy vepra penale të mashtrimit me subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së, atëherë pretendohet se kundër të dënuarit do të duhej që veprat penale të trajtoheshin si një vepër penale në vazhdim dhe njëkohësisht do të shqiptohet një dënim për veprat penale të kryera në vazhdim.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Duke shqyrtuar pretendimet e paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit G. M. se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në vendimin gjyqësor. Gjykata Supreme e Kosovës fillimisht vëren faktin se i dënuari gjatë shqyrtimit fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe i cili pranim nuk kontestohet as përmes kërkesës së paraqitur.

Mbrojtësi i të dënuarit i referohet dispozitës së nenit 242 par.6 të KPP-së e cila ka përcaktuar opsionet pas pranimit të fajësisë dhe plotësimit të kriterëve për pranimin e fajësisë gjegjësisht përkufizohet si në vijim: *”Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar çështjet nga paragrafit 2 i këtij neni, ai merr aktvendim për miratimin e pranimit të fajësisë dhe procedon me shqiptimin e dënimit, e cakton seancën sipas nenit 356 të këtij Kodi për të përcaktuar çështje që janë të rëndësishme për shqiptimin e dënimit ose e pezullon shqiptimin e dënimit deri në përfundimin e bashkëpunimit nga i pandehuri me prokurorin e shtetit.”*

Nga leximi i dispozitës del se pas miratimit të pranimit të fajësisë mbesin tri opsione dhe atë e para që të procedohet me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për shqiptimin e dënimit ose pezullimin e shqiptimit të dënimit deri në përfundim të bashkëpunimit nga i pandehuri dhe prokurori i shtetit. Kurse në rastin konkret duke u bazuar në shkresat e kësaj çështje penale del se gjykata (kryetari i trupit gjykues) është përcaktuar për seancën për shqiptimin e dënimit, me ç’rast janë marrë të dhëna nga shërbimi sprovues dhe është vazhduar me shqiptimin e dënimit, kurse njëkohësisht nuk është pezulluar shqiptimi i dënimit deri në bashkëpunim të të pandehurit.

Gjykata Supreme e Kosovës përgjithësisht i pranon argumentet e theksuara nga ana e mbrojtësit të të dënuarit për vështirësitë eventuale që mund të rrjedhin gjatë procedimit të mëtejshëm të procesit gjyqësor në çështjen penale ku tani i dënuari e ka statusin e dëshmitarit bashkëpunues, mirëpo në asnjë rrethanë nuk mund të vlerësoj rolin dhe aspektet e bashkëpunimit mes të tani të dënuarit dhe prokurorit të shtetit pasi që ato paraqesin marrëveshje mes këtyre palëve dhe se epilogu final i kësaj marrëveshje dhe çështjes penale si tërësi ku tani i dënuari ka rolin e dëshmitarit bashkëpunues është ekskluzivisht çështje e tyre dhe nuk lejon ndërhyrje nga

ndonjë autoritet tjetër dhe as autoritetit gjyqësor, kjo duke u bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë materien e dëshmitarëve bashkëpunues (neni 231 i KPP-së).

Sa i përket pretendimit përkitazi me dënimin e shqiptuar dhe faktin se dënimi është i ashpër, Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje të pretenduara të ligjit penal përkitazi me shqiptimin e dënimit pasi që dënimi i shqiptuar ka qenë brenda kornizave të minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar për veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe është gjykuar, meqë konform dispozitës së nenit 385 par.5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore, që në këtë rast nuk ka ndodhur. Për më tepër, fakti i potencuar në kërkesë, përkatësisht premtimi që të dënuarit t'i shqiptohet dënim më i butë se dënimi i shqiptuar sipas aktgjykimeve të kundërshtuara del se nuk është i bazuar për faktin se nuk është qartësuar se mbi bazën e cilit dokument apo shkresë është bërë një premtim i tillë, kjo duke pasur parasysh se një argument i tillë nuk është përmendur as gjatë seancës fillestare dhe as gjatë seancës për caktimin e dënimit.

Duke shqyrtuar pretendimet e paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit H. B., Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se kundër të dënuarit janë duke u zhvilluar dy proceduara gjyqësore sipas lëndëve të evidentuara nga ana e PSRK-së dhe atë: PPS.nr.89/2023 e datës 22.11.2023 për të cilën është nxjerrë aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.20/2024 të datës 13.03.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.23/2024 të datës 10.07.2024 e gjithashtu është duke u zhvilluar edhe procedura penale e evidentuar sipas aktakuzës PPS.nr.88/2021 e datës 04.12.2021 e për të cilën çështje rrjedh se është lidhur marrëveshja për pranimin e fajësisë mes të pandehurit dhe prokurorit të shtetit. Megjithatë për shkak të fakti se rasti “Subvencionet” është ndarë në disa pjesë e potencuar edhe nga ana e mbrojtësit të të dënuarit del se të gjitha këto çështje nuk kanë marrë epilog dhe nuk janë trajtuar si një çështje penale, andaj nga kjo arsye edhe pse përgjithësisht mund të qëndrojnë argumentet e paraqitura në kërkesë, mirëpo të njëjtat nuk mund të zbatohen deri sa nuk dihet ende epilogu i rastit të evidentuar sipas aktakuzës PPS.nr.88/2021 e datës 04.12.2021 se në cilën fazë të procedurës penale gjendet, kjo duke marrë parasysh faktin se këtë çështje penale ka një numër të madh të personave që janë pjesë e procedurave sipas rastit të evidentuar si “Subvencionet”. Për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton faktin se

mundësia e shqiptimit të dënimit unik nuk përfundon me epilogun e këtij aktgjykimi, por si e tillë mund të zbatohet në rastin kur aktgjykimet e dy rasteve marrin formën e prerë, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 420 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.665/2024, më 31 tetor 2024

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj